

Zyrës për Doktoraturë te Universitetit të Tetovës
Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik

Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës në mbledhjen, e mbajtur më **25.06.2026** solli Vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin shkencor dhe profesional e dorëshkrimit të temës së doktoraturës me titull: **“EVOLUCIONI I LIDERSHIPIT DHE MARRËDHËNIET ME MASËN NË KOSOVË (1999-2024): KLASIFIKIMI I LIDERËVE SIPAS PERFORMANCËS DHE TAKTIKAVE”** të kandidates **Mr. Suada Çerkezi**.

Në bazë të vendimit **16-432/2** të datës **25.06.2026**, Komisioni i përbërë nga: **Prof.dr. Kushtrim Ahmeti** (kryetar), **Prof.dr. Abdynaser Sinani**, **Prof.dr. Qani Nesimi**, **Prof.dr. Ardita Abduli-Reka** (anëtarë) dhe **Prof.dr. Ibish Kadriu** (mentor), pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës, i paraqet këtë:

RAPORT

për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës

1. Të dhënat biografike për kandidatin

Kandidatja **Mr. Suada Çerkezi**, e lindur më 3 qershor 1975 në Tiranë, Republika e Shqipërisë. Shkollën e mesme e ka kryer në Kamëz, Tiranë. Studimet deridiplomike në Kolegji AAB, Prishtinë, Komunikimit Masiv. Studimet master i ka përfunduar në Kolegjin AAB, Prishtinë, në drejtimin Komunikim Masiv dhe Gazetari. Studimet e doktoraturës i ka regjistruar në vitin akademik 2021/2022 në Universitetin e Tetovës, Fakultetin Filozofik, programi studimor: Sociologji, drejtimi: Socio-kulturor.

Përvoja e punës së kandidates **Mr. Suada Çerkezi** përfshin angazhime të shumta, kryesisht në sektorin civil, nga të cilat do të veçonim: Koorditore për Dialog ndërfaqetor dhe bashkëpunim institucional, në World Conference of Religions for Peace, Kosovë (2001–2006); Koorditore e Komunikimit dhe informacionit në Global Social Cohesion Community Inc., Prishtinë (2006–2011); Koorditore e Mbështetjes dhe integritetit të refugjatëve, në Global Social Cohesion Community Inc., Ottawa (2022–2023); Këshilluese e certifikuar për karrierë, integrim profesional dhe tranzicion në tregun kanadez të punës, Ottawa (2023–2025). Nga viti 2025, themeluese dhe Drejtuese e Arcana Access, praktikë këshilluese në fushën e lidërsipit, komunikimit dhe dinamikave organizative, Ottawa, Kanada.

2. Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara nga kandidati gjatë studimeve të doktoratës

Kandidatja Mr. Suada Çerkezi që nga fillimi i studimeve në ciklin e tretë të doktoraturës e këndeje, ka dëshmuar interes dhe progres të kënaqshëm në fushën e hulumtimit dhe të punimit të disertacionit të doktoraturës. Ajo me sukses ka realizuar tri konferencat doktorale, gjatë të cilave ka prezantuar rezultatet e hulumtimit.

Nga punimet e botuara gjatë kësaj periudhe kemi veçuar:

- *Social and Economic Integration of Muslim Immigrant Women in Canada*, në: International Journal of Humanities Social Science and Management (IJHSSM) Volume 4, Issue 5, 2024.
- *Between Tradition and Modernity Qualitative Insights into Cultural Preservation Efforts in Kosovo*, në: International Journal of Humanities Social Science and Management (IJHSSM) Volume 4, Issue 5, 2024.

3. Analizë e disertacionit të doktoraturës

Disertacioni i doktoraturës me titull: **“EVOLUCIONI I LIDERSHIPIT DHE MARRËDHËNIET ME MASËN NË KOSOVË (1999-2024): KLASIFIKIMI I LIDERËVE SIPAS PERFORMANCËS DHE TAKTIKAVE”**, i kandidates **Mr. Suada Çerkezi** përbëhet nga Hyrja, gjashtë kapituj, Përfundimi dhe Rekomandim si dhe Bibliografia.

Kapitulli i parë, KORNIZA TEORIKE, është ndarë në këto nëntituj: Përkufizimet dhe konceptet themelore të lidërshipt; Dinamika lider-ndjekës në politikë; Faktorët psikologjikë në sjelljen e votuesve dhe liderëve; Komunikimi masiv dhe ndikimi në Lidërshiptin politik.

Lidërshipti politik mund të kuptohet si një fenomen kompleks që përfshin mënyrën se si individët dhe grupet udhëheqin, ndikojnë dhe formësojnë proceset vendimmarrëse në kontekste kombëtare e ndërkombëtare. Ai nuk kufizohet vetëm në autoritetin formal, por duket se përfshin edhe dinamika sociale, emocionale dhe psikologjike që përcaktojnë marrëdhëniet ndërmjet liderëve dhe ndjekësve.

Lidërshipti nënkupton një proces strategjik të menaxhimit të marrëdhënieve ndërpersonale dhe të përdorimit të komunikimit për të ndërtuar besim dhe përkushtim te ndjekësit. Modelet bashkëkohore, ndërkohë, nënvizojnë se lidërshipti transformues dhe ai karizmatik mund të jenë veçanërisht të rëndësishëm për mobilizimin e komuniteteve dhe orientimin e tyre gjatë periudhave të tranzicionit apo krizës. Lidërshipti politik shihet si një proces dinamik dhe shumëdimensional që përfshin aftësinë për të udhëhequr, për të ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme me ndjekësit dhe për të orientuar shoqëritë drejt zhvillimit.

Kapitulli i dytë, *EVOLUCIONI HISTORIK I LIDERSHIPIT NË KOSOVË* (1999-2024), është ndarë në këto nëntituj: Përkufizimi i lidershipit politik në kontekstin kosovar; Lidershipi si refleksion i kulturës; Ndikimi i UÇK-së dhe UNMIK-ut në formimin e lidershipit; Faza e Pavarësisë (2008-2013); Faza e Krizave Politike dhe Demokratike (2013-2024).

Periodha e tranzicionit në Kosovë (1999-2008) shënoi formësimin e një lidershipi politik që mbështetej më shumë në kapitalin simbolik të luftës dhe në përkrahjen ndërkombëtare sesa në konkurrencën institucionale. Legjitimiteti politik u ndërtua mbi perceptimin e elitave si bartës të sakrificës kolektive dhe të identitetit kombëtar.

Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) strukturoi procesin qeverisës dhe vendosi standarde administrative, por prania e tij kufizoi autonominë politike dhe krijoi varësi të thellë nga vendimmarrja ndërkombëtare. Nën këtë ndikim, interesat strategjike ndërkombëtare shpesh mbizotëruan ndaj prioriteteve vendore, duke prodhuar një sistem hibrid të qeverisjes ku kontrolli narrativ dhe simbolika politike fituan më shumë peshë sesa ndërtimi i institucioneve funksionale.

Kapitulli i tretë, *KLASIFIKIMI I LIDERËVE SIPAS PERFORMANCËS DHE TAKTIKAVE*, është ndarë në këto nëntituj: Performanca politike dhe ndikimi i liderëve në qeverisje; Taktikat politike dhe stilistikat e lidershipit; Marrëdhënia lider-masë; Matrica krahasuese për vlerësimin e liderëve kryesorë (1999-2024).

Vlerësimi i lidershipit politik nuk është një ushtrim teknik, por një proces i ndërlikuar gjykim. Ai kërkon të kuptohet jo vetëm çfarë bëjnë liderët, por si e përkthejnë pushtetin në besim, autoritet dhe orientim moral. Në literaturën krahasuese, suksesi i lidershipit lidhet më pak me jetëgjatësinë në pushtet dhe më shumë me aftësinë për të prodhuar politika që japin rezultate të ndjeshme për qytetarët. Performanca politike nuk është vetëm çështje e efikasitetit administrativ, por një formë e brendshme e komunikimit me publikun. Një proces që ndikon në ndërtimin e besimit përmes veprimit të dukshëm dhe përgjegjshmërisë publike.

Në demokracitë e konsoliduara, vlerësimi i performancës mbështetet në tregues të matshëm: transparencë fiskale, efikasitet të politikave publike, pjesëmarrje qytetare dhe menaxhim të krizave. Në shoqëritë e brishta, standardet nuk mund të maten me të njëjtën rregull. Institucionet janë ende në ndërtim, dhe për këtë arsye pritjet janë shpesh kontradiktore.

Në vende ku besimi publik është i pasigurt, performanca politike shërben më shumë si instrument mbijetese sesa si tregues i zhvillimit. Kjo mund të jetë veçanërisht e dukshme në kontekste si Kosova, ku autoriteti politik shpesh ndahet mes institucioneve vendore dhe strukturave ndërkombëtare.

Në këtë kontekst bëhet relevant koncepti i “qeverisjes mjaftueshmërisht të mirë” (good enough governance), një formë qeverisjeje që mund të mos jetë ideale, por është e mjaftueshme për të ruajtur funksionimin bazë të shtetit dhe për të shmangur kolapsin institucional.

Kapitulli i katërt, *MARRËDHËNIA LIDER-MASË DHE STRATEGJITË E KOMUNIKIMIT*, është ndarë në këto nëntituj: Media si makineri legjitimimi; Roli i mediave sociale në krijimin e imazhit të liderëve në Kosovë (2017-2024); Branding-u diplomatik dhe legjitimiteti; Ndërkombëtarët dhe perceptimi qytetar; Protesta si instrument i pamjaftueshëm; ndërmjet shpërthimit emocional, instrumentalizimit politik dhe braktisjes institucionale; Largimi i grave nga partitë politike si akt mosnënshkrimi; Shoqëria civile si presion i padukshëm.

Në epokën digjitale fuqia politike rinovohet çdo ditë përmes besueshmërisë së performuar, më shumë sesa përmes autoritetit formal. Mediat tradicionale dhe platformat digjitale janë shndërruar në hapësira të testimi të përhershëm të autoritetit, ku aftësia për të ndërtuar lidhje emocionale me qytetarët mund të jetë po aq vendimtare sa kompetenca qeverisëse. Kjo zhvendosje nga autoriteti institucional drejt performancës publike e vendos komunikimin politik si element të rëndësishëm të funksionimit të qeverisjes.

Në rastin e Kosovës, kjo dinamikë merr trajta të veçanta. Elitat politike shpesh kanë ndërthurur simbolet e luftës, retorikën e pavarësisë dhe komunikimin e ndërmjetësuar nga media për të ndërtuar figura të ndryshme të autoritetit. Ky kapitull eksploron tensionin mes legjitimitetit të fituar nëpërmjet institucioneve dhe atij të performuar në publik, duke shqyrtuar ndikimin e krizave, protestave, branding-ut diplomatik dhe presionit ndërkombëtar në marrëdhënien lider-masë.

Në thelb, cilësia e demokracisë në Kosovë është e pandashme nga transparenca komunikative dhe pjesëmarrja qytetare. Standardet demokratike nuk maten vetëm përmes strukturave formale, por përmes mënyrës se si pushteti justifikohet publikisht. Deficiti demokratik shpesh lind nga boshllëqet midis komunikimit politik dhe përfaqësimit real.

Komunikimi politik në Kosovë gjatë 1999-2024 nuk është ndërtuar mbi modele abstrakte, por mbi mekanizma të matshëm që lidhnin liderët me masën. Two-Step Flow karakterizoi fazën e parë, Agenda Setting fazën e dytë, Spiral of Silence reflektoi frikën dhe autocensurën, ndërsa Framing mbeti strategjia më e qëndrueshme për ndërtimin e realitetit politik. Këto mekanizma dëshmojnë se komunikimi masiv është bërë boshti i legjitimitetit politik në Kosovë, sepse mënyra e shpërndarjes, heshtjes apo kornizimit të informacionit ka ndikuar jo vetëm diskursin publik, por edhe mënyrën se si ndërtohet autoriteti politik.

Kapitulli i pestë, *METODOLOGJIA E HULUMTIMIT*, është ndarë në këto nëntituj: Qasja metodologjike dhe dizajni i studimit; Detyra shkencore, pyetjet dhe hipotezat kërkimore; Popullacioni, kampioni dhe procedura e përzgjedhjes; Metodatat kërkimore (qasja cilësore dhe sasiore); Instrumentet e mbledhjes së të dhënave; Procedura dhe realizimi i hulumtimit; Burimet dhe kufizimet e studimit; Konsideratat etike dhe besueshmëria; Menaxhimi i të dhënave dhe validimi i rezultateve.

Metodologjia përbën bazën strukturore të këtij studimi, sepse përcakton mënyrën se si konceptet teorike të lidhshëm, komunikimi dhe legjitimiteti politik operacionalizohen dhe interpretohen në realitetin kosovar. Qëllimi nuk kufizohet në përshkrimin e metodave, por në shpjegimin e arsyes pse janë përzgjedhur, çfarë synojnë të zbulojnë dhe si kontribuojnë në qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë analitike të rezultateve.

Për shkak të kompleksitetit të temës dhe natyrës ndërdisiplinore të fenomenit, është përzgjedhur qasja e përzier (mixed methods research), e cila ndërthur analizën sasiore me atë cilësore. Studimi mbështetet në Sequential Explanatory Design, ku faza sasiore shërben për identifikimin e trendeve empirike, ndërsa analiza cilësore përdoret për interpretimin e mekanizmave diskursivë, simbolikë dhe komunikues që lidhen me legjitimitetin politik.

Kjo zgjedhje mbështetet në parimin epistemologjik se fenomenet shoqërore nuk mund të reduktohen vetëm në matje numerike, por kërkojnë interpretim të përvojës njerëzore. Në këtë mënyrë, metodologjia synon të pasqyrojë në mënyrë të balancuar marrëdhënien ndërmjet mediave, liderëve dhe qytetarëve, duke kombinuar dimensionin racional të analizës statistike me atë interpretues dhe diskursiv.

Kapitulli i gjashtë, *DISKUTIMI DHE ANALIZA E GJETJEVE*, është ndarë në këto nëntituj: Kuadri analitik dhe lidhja me objektivat e studimit; Gjetjet sasiore dhe interpretimi i trendeve empirike; Gjetjet cilësore dhe forma narrative e legjitimitetit politik; Integrimi ndërmetodologjik dhe dialogu me literaturën teorike; Implikimet konceptuale dhe praktike të gjetjeve.

Analiza mbështetet në kombinimin e të dhënave sasiore me interpretimin teorik të koncepteve të lidhshëm, racionalizimit institucional dhe komunikimit politik. Rezultatet statistikore të anketës përdoren si bazë empirike për të identifikuar tendencat kryesore në perceptimin e legjitimitetit politik, ndërsa literatura teorike shërben për të interpretuar kuptimin e këtyre transformimeve në nivel më të gjerë shoqëror dhe institucional. Fillimisht trajtohet raporti ndërmjet kapitalit akademik dhe racionalizimit të perceptimit politik, më pas diskutohet roli i kompetencës informative në ndërtimin e legjitimitetit politik dhe tensioni ndërmjet autoritetit karizmatik dhe institucionalizimit të pushtetit.

Pastaj analizohen diferencat brezore, roli i mediave në ndërmjetësimin e autoritetit politik dhe evolucioni i marrëdhënies lider–ndjekës në Kosovë. Në rastet ku të dhënat cilësore rezultojnë relevante për interpretimin e gjetjeve statistikore, ato integrohen si elemente plotësuese dhe kontekstualizuese të analizës.

Kapitulli i shtatë, ANALIZA KRAHASUESE DHE INTEGRIMI I GJETJEVE, është ndarë në këto nëntituj: Transformimi i legjitimitetit politik në Kosovë; Lideri dhe masa: evolucioni i marrëdhënies politike; Ndërkombëtarët dhe sovraniteti i ndërmjetësuar; Performanca, transparenca dhe racionalizimi i lidershipit; Protesta, skepticizmi dhe mobilizimi qytetar; Memoria kolektive dhe kapitali historik; Përfundimi sintetik i kapitullit.

Marrëdhënia lider–masë në Kosovë gjatë periudhës 1999–2024 mbetet aktive, por në materialin e analizuar shfaqet më pak homogjene dhe më e kushtëzuar. Mobilizimi kolektiv dhe simbolik i fazës së parë bashkëjeton me forma më selektive të angazhimit, ku besimi institucional, performanca e perceptuar dhe pritshmëritë pragmatike shfaqen me peshë të dukshme krahas kapitalit historik dhe figurës personale.

Diskurset e liderëve të analizuar ofrojnë katër modele të dallueshme të raportit me ndërkombëtarët: legjitimiteti i mbështetur (Rugova), partneriteti shtetformues (Thaçi), proceduralizmi europian (Mustafa) dhe sovranizmi vendimmarrës (Kurti). Bashkëjetesa e këtyre modeleve gjatë periudhës sugjeron se sovraniteti i ndërmjetësuar nuk shfaqet vetëm si fazë kalimtare, por si tipar i përsëritur i raportit ndërmjet autonomisë politike dhe kushtëzimeve të jashtme në kontekstin e një shteti të ri dhe ende të konsoliduar.

Përfundimi: KONKLuzionet FINALE DHE IMPLIKACIONET E STUDIMIT, është ndarë në këto nëntituj: Sinteza e gjetjeve kryesore; Statusi i hipotezave H1-H7; Konkluzione mbi legjitimitetin politik kosovar; Kufizimet metodologjike; Implikimet teorike dhe praktike; Rekomandimet për hulumtime të ardhshme; Konkluzionet përfundimtare dhe mbyllja.

Ky studim u nis nga pyetja se si ka evoluar lidershipi politik dhe marrëdhënia ndërmjet liderëve dhe masës në Kosovë gjatë periudhës 1999–2024, dhe si janë ndërtuar perceptimet mbi legjitimitetin politik përmes performancës, komunikimit, kapitalit historik dhe kontekstit institucional. Përgjigja që ofron materiali i analizuar nuk është e thjeshtë dhe nuk ka karakter të vetëm.

Komunikimi politik dhe diskursi publik i liderëve shfaqen si mekanizma aktivë të ndërtimit të autoritetit, por nuk funksionojnë si burim i vetëm i legjitimitetit: ata veprojnë në bashkëveprim me kapitalin historik, pritshmëritë për performancë, faktorin ndërkombëtar dhe memorien kolektive. Studimi sugjeron se legjitimiteti politik kosovar nuk ka ndjekur një trajektore lineare nga autoriteti karizmatik post-lufte te racionaliteti institucional.

Pesë profilet e liderëve të analizuar paraqesin konfigurime të ndryshme të burimeve të legjitimitetit, të cilat bashkëjetojnë dhe riaktivizohen sipas kontekstit. Kapitali historik mbetet i pranishëm si shtresë referenciale aktive.

Në pjesën e **Bibliografisë/ Literaturës së shfrytëzuar** janë rradhitur në bazë të rendit alfabetik të gjitha burimet dhe literatura e shfrytëzuar dhe konsultuar nga ana e kandidatës për hartimin e këtij disertacioni. Për hartimin e temës kandidati ka shfrytëzuar kryesisht vepra, punime shkencore, literaturë të përgjithshme kryesisht në gjuhën shqipe dhe angleze.

4. Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura

Gjatë hartimit të punimit të doktoraturës me titull **“EVOLUCIONI I LIDERSHIPIT DHE MARRËDHËNIET ME MASËN NË KOSOVË (1999-2024): KLASIFIKIMI I LIDERËVE SIPAS PERFORMANCËS DHE TAKTIKAVE”**, kandidatja është mbështetur dhe ka respektuar teorinë shkencore dhe metodologjinë e punës kërkimore-shkencore. Janë shfrytëzuar disa metoda shkencore, si, përshkrimi, analiza, krahasimi dhe kritikizmi. Për shkak të natyrës së punimit, ndarja është bërë sipas tematikës, çdo nëntemë është e lidhur me njëra-tjetrën.

Për shkak të natyrës së punimit metoda përshkruese ka gjetur më shumë përdorim. Fillimisht janë përshkruar në formë koncize tri romanet që përbejnë Trilogjinë e Kajros dhe nga të njëtat janë përzgjedhur aspektet sociale, të cilat i janë shtruar kritikës, apo thenë më saktë metodës së kritikizmit. Punimi ka synuar dhe me sukses ka arritur që tju jap përgjigje pyetjeve kërkimore. Kandidatja pasi një gjuhën angleze në nivel akademik, kjo i ka ndihmuar që të shfletoj dhe shfrytëzoj burime relevante, teori bashkëkohore mbi leadershipin.

5. Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit

Rezultatet kryesore të disertacionit të doktoraturës me titull: **“EVOLUCIONI I LIDERSHIPIT DHE MARRËDHËNIET ME MASËN NË KOSOVË (1999-2024): KLASIFIKIMI I LIDERËVE SIPAS PERFORMANCËS DHE TAKTIKAVE”**, mund të rezimohen si më poshtë:

Ky hulumtim ndërmerr një përpjekje të parë të strukturuar për të analizuar leadershipin politik në Kosovë përmes marrëdhënies lider-ndjekës gjatë periudhës 1999-2024. Në këtë studim, termi ndjekës nuk kuptohet si një masë pasive, por si një grup aktorësh shoqërorë që ndërveprojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me liderët - qytetarë dhe votues, diaspora, mediat dhe opinion-bërësit, si edhe rinia dhe grupet e aktivistëve politikë. Kjo qasje zhvendos vëmendjen nga koncepti i leadershipit të izoluar drejt një procesi të ndërsjellë, ku liderët dhe ndjekësit formësojnë së bashku legjitimitetin dhe performancën politike.

Rëndësia akademike e këtij studimi qëndron në integrimin e teorive moderne mbi leadershipin dhe ndjekësinë në një kontekst specifik post-konfliktual. Aplikimi i këtyre qasjeve në Kosovë pas vitit 1999, një terren i shënuar nga tranzicione institucionale dhe ndërhyrje ndërkombëtare, mund të shihet si kontribut origjinal në literaturën mbi leadershipin politik në shoqëritë tranzicionale. Ndërkohë, pozicionimi i rastit të Kosovës në kuadrin më të gjerë të tranzicioneve politike në Ballkanin Perëndimor ofron pikënisje të vlefshme për reflektim teorik, edhe pse ky studim nuk synon krahasim empirik me vendet e tjera të rajonit.

Rëndësia praktike lidhet me aftësinë e këtij studimi për të treguar se si leadershipi politik në Kosovë ka fituar ose humbur legjitimitetin përgjatë tri fazave historike: tranzicionin (1999-2008), konsolidimin (2008-2013) dhe rindërtimin demokratik (2013-2024). Analiza e performancës dhe e taktikave të liderëve tregon se ndjekësit kanë ushtruar ndikim të drejtpërdrejtë në formësimin e narrativës politike, në protestat qytetare dhe në reagimet ndaj krizave institucionale. Këto gjetje mund të shërbejnë si udhëzues për politikëbërësit, analistët dhe shoqërinë civile mbi mënyrën se si ndërtohet leadershipi demokratik dhe gjithëpërfshirës.

6. Kontributet kryesore shkencore të kandidates

Studimi ka kufizimet e veta metodologjike të dokumentuara dhe nuk pretendon shterim. Ai ofron një lexim empirikisht të bazuar dhe teorikisht të mbështetur të transformimeve të leadershipit politik kosovar, duke kontribuar në kuptimin e legjitimitetit si proces dinamik, i shtresëzuar dhe i negociuar vazhdimisht ndërmjet liderëve, institucioneve dhe qytetarëve. Ky përbën kontributin qendror të këtij disertacioni.

Gjetja qendrore sasiore, diferenca sipas arsimimit në perceptimin e kompetencës informative, sugjeron se respondentët me nivel më të lartë arsimimi e pranojnë më lehtë logjikën e autoritetit institucional të informuar. Gjetja plotësuese mbi preferencën gjinore për leadershipin vizionar dhe mobilizues tregon se dimensionin gjinor meriton vëmendje empirike të thelluar në hulumtime të ardhshme. Bashkërisht, këto dy gjetje sasiore nuk prodhojnë një model të ri, por ofrojnë pika referimi empirike për interpretimin e raportit ndërmjet nivelit të arsimimit, gjinisë dhe perceptimit të autoritetit.

Kontributi metodologjik qëndron në zhvillimin e matricës krahasuese të performancës së liderëve, e cila kombinon tregues të legjitimitetit, komunikimit politik dhe performancës institucionale. Kjo matrice, e krijuar posaçërisht për këtë studim, përbën një instrument analitik që mund të aplikohet edhe në kontekste të tjera post-konfliktuale, duke e bërë hulumtimin të vlefshëm përtej rastit të Kosovës.

Metodologjikisht, studimi mbështetet në një qasje të kombinuar që përfshin analizë diskursive të komunikimeve politike, krahasim sistematik të performancës institucionale dhe interpretim të të dhënave statistikore mbi perceptimin publik.

7. Hulumtime të mundshme të ardhshme

Disertacioni i doktoraturës “**EVOLUCIONI I LIDERSHIPIT DHE MARRËDHËNIET ME MASËN NË KOSOVË (1999-2024): KLASIFIKIMI I LIDERËVE SIPAS PERFORMANCËS DHE TAKTIKAVE**”, është temë specifike dhe brënda saj janë trajtuar tematika të ndryshme, kjo krijon mundësi për të qënë një bazë e mirë për hulumtime të ardhshme.

- *Zgjerimi i korpusit diskursiv.* Analiza diskursive e këtij studimi u mbështet në materiale të zgjedhura publike. Zgjerimi i korpusit duke përfshirë platformat digjitale dhe rrjetet sociale në mënyrë sistematike do të mundësonte shqyrtimin nëse ligjërimet e liderëve në platforma të ndryshme prodhojnë profile të ndryshme legjitimiteti ose nëse diskursi tradicional dhe ai digjital konvergojnë;
- *Zgjerimi i materialit intervistues.* Roli plotësues i materialit intervistues në këtë studim hap hapësirë për hulumtime të ardhshme që realizojnë intervista të strukturuar ose gjysmë-strukturuar me aktorë politikë, institucionalë dhe mediatikë;
- *Dimensioni gjinor i leadershipit.* Gjetja e kufizuar mbi preferencën gjinore për leadershipin vizionar dhe mobilizues sugjeron se ky dimension meriton vëmendje më të thelluar empirike. Ndërtimi i instrumenteve më të specializuara do të mundësonte matjen e diferencimit gjinor në perceptimin e formave të ndryshme të autoritetit politik, duke shkuar përtej nivelit deskriptiv të identifikuar në këtë studim;
- *Diferencimi i faktorit ndërkombëtar.* Rezultatet mbi faktorin ndërkombëtar nuk prodhuan dallime të forta statistikisht domethënëse, por treguan tensione interpretuese ndërmjet besimit pragmatik ndaj aktorëve ndërkombëtarë dhe kërkesës për autonomi politike vendore;
- *Krahasimi rajonal.* Rasti i Kosovës ofron bazë të përshtatshme për studime krahasuese me shoqëri të tjera post-konfliktuale të Ballkanit Perëndimor, ku shtetformimi, ndërhyrja ndërkombëtare dhe memoria e konfliktit ndërveprojnë në konfigurime të ndryshme. Krahasimi do të lejonte shqyrtimin nëse konfigurime të ngjashme të bashkëjetesës së burimeve të legjitimitetit shfaqen edhe jashtë kontekstit kosovar.

Vlerësim dhe rekomandim

Nisur nga vlerësimet e sipërthëna Komisioni për vlerësimin e dorëshkrimit të disertacionit të doktoraturës **“EVOLUCIONI I LIDERSHIPIT DHE MARRËDHËNIET ME MASËN NË KOSOVË (1999-2024): KLASIFIKIMI I LIDERËVE SIPAS PERFORMANCËS DHE TAKTIKAVE”**, të kandidatës **Mr. Suada Çerkezi**, në përbërje të mëposhtme, ka nderin që ti propozoj Këshillit Mësimor –Shkencor të Fakultetit Filozofik miratimin e këtij Raporti dhe të krijoj kushte për mbrojtjen publike të këtij disertacioni të doktoraturës.

Komisioni Recenzues:

1. Prof. Dr. Kushtrim Ahmeti (Kryetar)
2. Prof. Dr. Abdylnaser Sinani (anëtar)
3. Prof. Dr. Qani Nesimi (anëtar)
4. Prof. Dr. Ardita Abdul- Reka (anëtar)
5. Prof. Dr. Ibish Kadriu (Mentor)



Tetovë, korrik 2026